

PËLLUMB XHUFI**MAQEDONIA PERËNDIMORE NË HISTORINË E ARBËRVE
TË SHEK. VII-XV**

Burimet e Antikitetit të Vonë e të Mesjetës së Hershme, ndonëse në mënyrë të mjegullt, bëjnë fjalë për një ndarje midis *Ilirisë* dhe *Greqisë*. Kështu, në veprën e tij *De aedificiis*, Prokopi i Qezaresë (shek. VI) flet për një ngushticë (Κλεισόυρα) në Veri të Termopileve, që sipas tij ndante Ilirinë nga Helada¹. Idenë e një “kufiri” mes Ilirisë dhe Greqisë në krahun e Maqedonisë Jugperëndimore e gjejmë të materializuar edhe në Novelën 11 të Justinianit, e cila kishte të bënte me krijimin e një qendre të re në Ilirik, Justiniana Prima, krahas asaj të mëparshme të Selanikut². Ky kufi kalonte paksa në Veri të Selanikut³. Elementë eksplicitë për drejtimin që ndiqte konkretisht ky kufi mund të gjejmë shekuj më vonë. Kështu, në shek. XIV, Kosturi konsiderohej si pjesë e Shqipërisë (*Castoria in partibus Albaniae*)⁴. Ky ishte skaji lindor i asaj, që nga shek. XVI e deri në fillim të shek. XX në një kuptim të gjerë u quajt *Shqipëri e Poshtme* (*Arbëni Poshtërë, Albania Inferior, Bassa Albania, Basse Albanie, Lower Albania, Κάτω Ἀλβανία*)⁵. Këtu, ashtu si në gjithë

¹ Procopius Caesariensis, *De aedificiis* (më tej: Proc., *de aed.*), IV, 1, 3-4 dhe 11-14, ed. Haury, f. 103-104; Gilbert Dragon, “Les villes dans l’Illyricum protobyzantin”, në: *Villes et Peuplement dans l’Illyricum Protobyzantin. Collection de l’Ecole Française de Rome*, 77, Rome: 1984, f. 3-4.

² G. Dragon, “Les villes...”, f. 3.

³ L. Maksimović, “L’Illyricum septentrionale au VI^e siècle”, në: *Zbornik Radova Vizantoloskog Instituta*, 19 (1980).

⁴ B. Krekić, *Dubrovnik (Raguse) et le Levant*, Paris: 1961, f. 229.

⁵ Pjetër Bogdani, *Cuneus Prophetarum*, Padova, 1685, bot. A. Omari, pj. I, Tiranë: 2005, f. 181 (*Arbëni Poshtërë*); Ph. Cluverius, *Introductio in universam geographiam tam veteram quam novam*, Guelferbyti, 1686, f. 387; G. Cantelli da Vignola, *Albania detta anche Macedonia occidentale*, Modena: 1689; Mauro Orbini, *Il regno de gli Slavi*, Pesaro: 1601, f. 148, 149; J. P. Bellaire, *Précis des opérations générales de la division française du Levant*, Paris: 1805; G. B. Depping, *La Grèce ou description topographique de la Livadie, de la Morée et de*

Maqedoninë, rrethanat etnike u ndërlikuan veçanërisht me vendosjen e ngulimeve sllave, pas dyndjeve të shek. VI-VII. Megjithatë, viset perëndimore ishin në periferi të drejttimeve kryesore të zbritjes së sllavëve drejt Selanikut e Thrakës, që në rastin e Maqedonisë ishin rrjedha e Strumicës dhe e Vardarit⁶. Burimet përkatëse nuk japin dëshmi të drejtpërdrejta të nguljes së sllavëve në këtë anë të Maqedonisë Perëndimore⁷. Ne dimë që në shek. VII, në hapësirën midis Verries e Manastirit ishte vendosur fisi sllav i *Dragubitëve*⁸. Ka mendime që më në perëndim të Manastirit mund të jenë vendosur sllavët *Verzitë*.⁹ Pavarësisht se të dhënat që flasin për një vendosje të popullsive sllave në këtë trakt të Maqedonisë Perëndimore janë të izoluara e më së shumti të pakonfirmuara nga burime të tjera, ne nuk mund të injorojmë të dhënat indirekte, që nënkuptojnë gjithsesi një shfaqje që në këtë kohë të elementit sllav edhe në brezin midis Vardarit e liqejve të Ohrit e Prespës. Kështu, burimet bizantine dëshmojnë se perandorë të ndryshëm bizantinë mes shek. VIII-XI, kryen deportimin masiv të popullsive sllave të kësaj treve, që siç kuptohet, ishin vendosur aty në periudhën e mëparshme. Perandoria Bizantine i konsideronte këto shpërngulje si një masë të domosdoshme për të siguruar lëvizjet në rrugët që çonin drejt qendrave

l'Archipel, vëll. I, Paris: 1823, f. 269 (*l'ancienne Epire, ou Basse Albanie*); J. C. Hobhouse, *A journey through Albania*, vëll. I, London: s. a., f. 176; Panajotis Aravantinos, *Perigraphe tes Epeirou*, vëll. I, Joannina: 1984, f. 121 (Κάτω Ἀλβανία). Termi *Shqipëri e Poshtme* për trevën e gjerë të Epirit e të Maqedonisë Jugperëndimore, u përdor edhe në gjuhën zyrtare të Athinës, deri në vitin 1913, kur ajo u aneksua në përfundim të Luftërre Ballkanike. Shih: Basilis Kondis, *Ellenismos tou Boreiou Epeirou kai elleno-albanikes scheseis*, vëll. I (1897-1918), Athinë: 1995, f. 237.

⁶ P. Lemerle, *Les plus anciens recueils des Miracles de Saint Demetrius et la pénétration des Slaves dans les Balkans*, Paris: 1979, f. 175, 214, 229.

⁷ Kristo Frashëri, "Emri i shqiptarëve gjatë mesjetës së hershme", në: *Aleks Buda in memoriam*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 2010, f. 14.

⁸ F. Barišić-B. Ferjančić, "Vesti Dimitrija Homatjana o vlasti Dragovita", në: *ZRVI*, 20 (1981), f. 41-48; I. Dujčev, "Dragovista-Dragovitia", në: *REB*, 22 (1964), f. 215-221.

⁹ G. Cankova-Petkova, "Über die Herkunft einiger slawischer Ethnonyme und Toponyme und ihre Bedeutung für das gesellschaft-politische Leben auf dem Balkan", në: F. Winkelmann (Ed.), *Byzanz im 7. Jahrhundert. Untersuchungen zur Herausbildung des Feudalismus*, Berlin: 1978, f. 73-76.

kryesore të Bizantit, Selanikut e Konstandinopojës¹⁰. Bashkësi të konsiderueshme sllave mbetën, megjithatë, sidomos në pjesën lindore e në atë qendrore të Maqedonisë. Në fillim të shek. XIII, Kryepeshkopi i Ohrit, Dhimitër Komatjanoi pohonte se, sinodi i dioqezës së tij përbëhej nga peshkopë “ilirë”, por edhe nga peshkopë “bullgarë”, por pa na e precizuar se ku kalonte kufiri i kësaj ndarjeje etnike¹¹. Gjithsesi, në shek. XV, në këtë krah ishte përvijuar një lloj kufiri mes shqiptarëve e sllavëve. Kronisti Gjon Muzaka përcaktonte në atë kohë si kufi ndarës mes Shqipërisë dhe “Bullgarisë”, malet e Peristerit, pranë Manastirit, apo më saktë burimin me emër Dobrida që zbriste nga ai mal (*s'incontrarno in uno loco nomine la montagna di Peristeri, e lì v'è una fontana nominata Dobrida, e là se divide l'Albania dalla Bulgaria*)¹². Por qysh në fillimet e shek. XIII, në një letërkëmbim mes mitropolitit të Naupaktit, Joan Apokaukos dhe Gjergj Bardhanit (Georg Bardanes), mitropolit i Korfuzit, ky brez, jo fort i qartë, që fillonte diku në Veri të Selanikut e përfundonte në bregdetin e Epirit, quhej pjesë e *Ilirisë*, ndërkohë që nga këndvështrimi i një grekofoni, siç ishte në rastin konkret Apokaukos, popullsia aty cilësohej si *barbarofone*.¹³ Në shek. XIV, kartat e mbretërve serbë për manastiret e Tetovës e të Shkupit, evidentojnë në mënyrë të qartë praninë e elementit shqiptar në ato treva¹⁴. Shqiptarët, të identifikuar si të tillë nga etnonimi “shqiptar” apo nga karakteri qartësisht shqiptar i emrave të tyre, i gjejmë si bujq, barinj e ushtarë, frekuentues të

¹⁰ G. Ostrogorsky, *Storia dell'Impero Bizantino*, Torino, 1968: f. 154.

¹¹ “πρόσεισιν ὑπερορίῳ συνόδῳ καὶ τῷ προκαθημένῳ αὐτῆς τῆ τῶν Ἰλλυριῶν ἱεραρχῶν δηλαδῆ, τῆ καὶ τῆν τῶν Βουλγαρῶν, ὕστερον κληρωμένῃ ἐπίκλησιν”, shih: J. B. Pitra, *Analecta sacra et classica Spicilegio Solesmensi parata*, vëll. VI, Paris-Roma: 1891, col. 579.

¹² G. Musachi, “Genealogia dei Musachi”, në: Ch. Hopf, *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues*, Berlin: 1873, f. 281.

¹³ V. Vassilievskij, “Epirotica saeculi XIII”, në: *Vizantijskij Vremjenik*, 3 (1896), f. 248.

¹⁴ A. Solovjev, “Jedna srpska župa za vreme carstva”, në: *Glasnik Skopskog Naučnog Drštva*, III (1928), f. 31-32; G. Palikruševa-A. Stojanovski, “Etničkite priliki vo severozapadna Makedonija vo XV vek”, në: *Jugoslovenski Istorijski Časopis*, 1-2 (1970), f. 35; S. Gashi, “Prania e etnosit shqiptar”, në: *Shqiptarët dhe trojet e tyre*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë: 1982, f. 257-258.

pazarit të manastirit të Shën Gjergjit (Shkup)¹⁵. Në këtë mënyrë, duket i drejtë konkluzioni i A. Ducellier, sipas të cilit, në prag të pushtimit turk, hapësira shqiptare ishte njëherësh shumë e gjerë e shumë e copëzuar, nëse përjashtojmë këtu Shqipërinë e sotme, Kosovën e një pjesë të mirë të Maqedonisë Perëndimore, ku popullsia shqiptare ishte dukshëm mbizotëruese¹⁶.

Gjatë shekujve të Mesjetës, në brezin e territoreve midis Ohrit e Manastirit, në Jug, e Dibrës e Pollogut, në Veri, janë përqendruar disa nga zhvillimet më emblematike të historisë së shqiptarëve dhe të marrëdhënieve të tyre me shtete e popuj të tjerë. Drejt Dibrës e Ohrit zgjateshin dy arteriet kryesore që fillonin nga qyteti-port i Durrësit dhe që çonin në thellësi të territorit bizantin. Në këtë vështrim, fakte të shumta të historisë politike, ekonomike, kulturore e fetare zhvillohen brenda një qerthulli gjeografik e njerëzor, ku përfshihen sa Durrësi dhe Arbri ("Ἀρβανον, Arbanum, Рабнь")¹⁷, aq edhe trevat më në Lindje të tij, ato të Dibrës, Shkupit, Ohrit, Devollit, Manastirit apo Kosturit. Në krahun jugor, mbrojtja e luginës dhe e vetë qytetit të Devollit, përbënte një domosdoshmëri strategjike për të mbyllur shtigjet që çonin nga Durrësi, Vlora e Butrinti drejt liqeneve maqedonianë e më tej drejt Selanikut¹⁸. Skilice-Kedreni, duke përmendur protagonistët e luftës kundër Bodinit të

¹⁵ S. Novaković, *Zakonski spomenici*, Beograd: 1912, f. 620; Kristo Frashëri, "Trojet e shqiptarëve në shek. XV", në: *Shqiptarët dhe trojet e tyre*, Tiranë: 1982, f. 208-209.

¹⁶ *Dans le monde balkanique, au temps de la conquête turque et bien au-delà, l'espace albanais est donc à la fois très vaste et très morcelé, si l'on en excepte l'actuelle Albanie, la Kosova et bonne part de la Macédoine occidentale, où le peuplement albanais est très majoritaire*. Shih: Alain Ducellier, "Les Albanais et les espaces intérieurs des Balkans à la fin du Moyen âge", në: *The Kosova Issue, a historic and current Problem. Symposium in Tirana 15-16 April 1993*, Tirana: 1996, f. 59.

¹⁷ Arbri, i pagëzuar ndryshe "bërthama e vendeve të shqiptarëve", përfshinte viset mes Lezhës, Durrësit, Ohrit e Dibrës, ku më së pari u shfaqën shenjat e një organizimi politik të shqiptarëve në Mesjetë. Shih: M. Angold, *A Byzantine Government in Exile*, Oxford Univ. Press: 1975, f. 280; G. Prinzig, "Studien zur Provinz- und Zentralverëaltung im Machtbereich der epirotischen Herrscher Michael I und Theodoros Dukas", në: *Epeirotika Chronika*, 25 (1983), f. 57; Pëllumb Xhufi, "Vëzhgime mbi emrin Arbëri dhe Arbëresh në Mesjetë", në: *Dilemat e Arbërit*, Tiranë: "Pegi", 2006, f. 3-23.

¹⁸ A. Ducellier, *La façade maritime ...*, f. 18.

Dioklesë, rreshton së bashku strategun e Ohrit, Marianin, *patrikun* e *antipatin* e Devollit dhe strategun e Kosturit¹⁹. Këtu, Devolli rezultoi të jetë qytet, por ne dimë gjithashtu se emri i referohej edhe një lumi²⁰ e gjithashtu një krahinë, ose më saktë dy krahinave: Devolli i madh e Devolli i vogël. Në 1253, të dy Devollët, bashkë me Kosturin e trevën e tij, u ndanë nga despoti i Epirit, Teodor Engjëlli, dhe kaluan në anën e perandorit Joan Vatatzë²¹. Me krerët e këtyre krahinave u bashkua me atë rast edhe Gulami, princi i Arbrit, i cili gjithashtu kishte ardhur atë kohë me ushtri, pikërisht në zonën e Kosturit²². Në fakt, qysh në prostagmën e vitit 1020 të lëshuar nga perandori bizantin, Bazili II, qyteti i Devollit shfaqet si një sufragani i peshkopatës së Kosturit²³. Pikërisht këtu, në qytetin e Devollit, erdhën e u dorëzuan tek perandori bizantin, në 1018, krerët e fundit bullgarë, që kishin rezistuar për ca kohë në malin e Tomorrit²⁴.

Në 1308, Dibra konsiderohej në mënyrë eksplicite si pjesë e Arbërisë²⁵. Dhe me siguri, në shek. XV, kjo krahinë e gjerë bënte pjesë në shtetin e Skënderbeut²⁶. Ky shtrihej përtej Drinit të Zi, deri në malet e Korabit, Kërçinit e Stogovës dhe përfshinte grykën e Radikës²⁷. Kështjella e Sfetigradit (Koxhaxhikut), paksa në jug të Dibrës, ishte një nga pikat kyç të sistemit mbrojtës të shtetit të Skënderbeut, dhe pushtimi i saj nga turqit, më 1448, u hapi rrugën në këtë krah sulmeve osmane,

¹⁹ “ἐκεῖσε γὰρ διατετελεῖσθαι τὴν πόλιν οἱ τὰ Ῥωμαίων φρονούντες, ὡς εἴρηται, ὁ τε τῆς Ἀχρίδος στρατηγὸς Μαρριανὸς καὶ ὁ τῆς Διαβόλεως ὁ πατρίκιος καὶ ἀνθύπατος Θεόγνωστος ὁ Βούρτζης, σὺν αὐτῷ δὲ καὶ ὁ ἐν Καστορίᾳ στρατηγῶν”, shih: Skylitzes-Kedrenos, *Synopsis Historiōn*, vëll. II, Bonn, 1839, f. 716.

²⁰ “*fluvium Daemoniorum*”, shih: G. Malaterra, “De rebus gestis Rogerii comitis”, në: *Raccolta degli Storici Italiani*”, vëll. V, Bologna: 1927, f. 74.

²¹ Georges Akropolites, *Chronike Syngraphe*, Lipsiae: 1903, f. 91.

²² *Po aty*.

²³ J. Ivanov, *Bllgarski starine iz Makedonija*, Sofija: 1931, f. 550.

²⁴ Skylitzes-Kedrenos, *Synopsis Historiōn*, vëll. II, Bonn: 1839, f. 469.

²⁵ “*Praeter has duas provincias habet juxta se et alias provincias, videlicet Culaniam, Stephanatum, Polatum, Debre*”, shih: O. Gorka, *Anonymi descriptio Europae Orientalis*, Cracoviae: 1916, f. 28.

²⁶ “*Ma dopo il Signor Scanderbeg fu Signore non solum della Matia, ma si fé Signore de Croia, de Dibra, de Birina, cioè de Randisia, Tomorista e Misia*”, shih: G. Musachi, *Genealogia ...*, f. 298-299.

²⁷ Kristo Frashëri, *Skënderbeu, jeta dhe vepra*, Tiranë: 2002, f. 181-182.

duke vërtetuar kështu rolin e madh strategjik në mbrojtje të trevave perëndimore e të qendrave bregdetare shqiptare që kishte luajtur vazhdimisht kjo krahinë²⁸. Në fakt, që në shek. XII, Ana Komnena, e kishte treguar Dibrën si mburojë e Arbrit: ai që zotëronte Dibrën, e kishte të hapur rrugën për t'u futur në Arbër nga ana e Lindjes²⁹. Të njëjtën gjë konfirmon një shekull e gjysëm pas saj, Georg Akropoliti, komandant i provincave perëndimore të Perandorisë Bizantine, i cili e rrëfen Dibrën si pikëmbërritjen e një marshimi të vështirë që ai bëri në dimrin e vitit 1257, duke u nisur nga Durrësi e duke përshkuar viset e rrepta të Arbrit nëpër Kunavi, Guri i Keq (Guri i Bardhë?), Mat, për të mbërritur më në fund në Dibër e prej këndeje në Kërçovë e Përlep³⁰.

Durrësi dhe Arbri kishin një lidhje thuajse organike me Ohrin dhe akoma më tej me Manastirin (Pelagoninë, Bitolën) e Selanikun, që ishin stacionet kryesore në krahun perëndimor të rrugës Egnatia “arteries kryesore të zemrës bizantine”³¹. Në vitin 1185, kundrejt invazionit norman, Selanikun e mbronte një repart me luftëtarë nga krahina e Kunavisë, në Arbër³². Kujtojmë, që para vitit 1014, *patrici* David Arianiti, shqiptar, u emërua prej perandorit bizantin Bazili II si qeveritar i Selanikut³³. Vite më vonë, një tjetër pinjoll i kësaj familjeje shqiptare, Kostantin Arianiti, me titullin *magister*, ishte emëruar komandant i provincave të Perëndimit (ὁ τῆς Δύσεως ἄρχων)³⁴. Pak më sipër përmendëm shkarazi faktin, që për të ruajtur unitetin gjeopolitik të kësaj treve, perandorët bizantinë proceduan në deportime masive të popullsisë sllave, që ishin vendosur aty gjatë dyndjeve të shek. VI-VII. Zhvendosjet

²⁸ *Po aty*, f. 158-159.

²⁹ Anna Comnena, *Alexias*, ed. A. Reifferscheid, vëll. II, Lipsiae: 1884, f. 190; G. Stadtmüller, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, 2, Auflage, Wiesbaden: 1966, f. 166.

³⁰ “ἐξορμήσας γοῦν τοῦ Δυρραχίου καὶ διελθὼν τὰ τῆς Χουναβίας καὶ τὸ ὄρος ὑπερβᾶς ὁ δὴ Κακὴν Πέτραν κατονομάζουσιν, εἰς τὰ περὶ τὴν Μάτην ἀπήειν καντεῦθεν περὶ τὴν Δέβρην ἀφίγμαι”, shih: *Akropolites*, f. 140.

³¹ M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, Beograd: 1925, f. 3-5, 34-35.

³² S. Kyriakides, *Eustazio di Tessalonica: La espugnazione di Tessalonica*, Palermo: 1961, f. 92.

³³ Scylitzes-Kedrenos, *Synopsis ...*, vëll. II, f. 454; A. Ducellier, “L’Arbanon et les Albanais au XI^e siècle”, në: *Travaux et Mémoires*, III (1968), f. 359.

³⁴ Scylitzes-Kedrenos, *Synopsis ...*, vëll. II, f. 596; Attaleiates, ed. I. Bekker, Bonn, 1853, f. 34.

e para të masave sllave në drejtim të Azisë së Vogël lidhen me emrin e perandorit bizantin Konstanti II (641-668). Në vitin 658 ky ndërmori një fushatë të madhe kundër sllavëve në Maqedoni, që u shoqërua me shpërnguljen e detyruar të masave të mëdha të sllavëve në Azinë e Vogël³⁵. Sipas Teofanit (shek. VII), edhe perandori Justinian II (685-695), pas ekspeditës së tij të vitit 689 kundër sllavëve të Maqedonisë, shpërnguli një masë të madhe të tyre në Bitini e në themën Opsikon të Azisë së Vogël³⁶. Numri i tyre duhet të ishte shumë i madh, përderisa prej këtyre sllavëve mund të formohej një ushtri prej 30 mijë trupash³⁷. Në vitin 762, perandori Konstantini V deportoi në Bitini të Azisë së Vogël 208 mijë sllavë³⁸. Të tjera valë shpërnguljesh të popullsisë sllave nga trevat e Maqedonisë perëndimore ndodhën edhe në kohën kur perandori Bazili II Bullgarovrasësi, shpartalloi perandorinë bullgare të Simeonit e Samuelit (1014). Me atë rast ai i shpërnguli mbeturinat e sllavëve nga Maqedonia Perëndimore në derdhjen e Danubit, Mesinë e Poshtme (κατὸ Μουσία)³⁹. Regjimi i themave, që Perandoria Bizantine aplikoi edhe në trevat shqiptare pas tërheqjes së rrezikut sllav (shek. IX), forcoi aty rolin e popullsisë autoktone dhe të forcave ushtarake lokale (ἐγκώροι δυνάμεις)⁴⁰. Shembullin më elokuent të këtij zhvillimi të ri e jep rasti i përmendur i strategëve Arianiti, nga familja e sundimtarëve të njohur shqiptarë të Elbasanit, që kontrollonin traktin perëndimor të rrugës Egnatia⁴¹.

³⁵ G. Ostrogorsy, *Storia dell'Impero ...*, f. 103, 132 shën. 77, 78.

³⁶ P. Charanis, "The Slavic Element in Byzantine Asia Minor", në: *Byzantion*, 18 (1948), f. 69 vj.; G. Ostrogorsky, *Storia dell'Impero ...*, f. 113-114, 134 shën. 109, 110; M. Gräbner, "The Slavs in Byzantine Population: Transfers of the 7th and 8th Centuries", në: *Études Balkaniques*, 11/1 (1975), f. 40-52.

³⁷ P. G. Papademetriou, "Thesmikes scheseis kai stadia ensomatoses ton slavikon plethysmon ste byzantine autokratoria kata to deutero miso tou 7^{ou} aiona", në: *Byzantina*, tom. 24, Tessalonike: 2004, f. 208.

³⁸ J. Herrin, në: *L'Impero Bizantino*. Storia Universale Feltrinelli 13, ed. F. G. Maier, Milano: 1974, f. 110.

³⁹ Nic. Gregorae, *Historia byzantina*, II, 2, 2 (ed. Bonn, 1830); Constantin Jireček, në: *Byzantinische Zeitschrift*, 13 (1904), f. 193.

⁴⁰ E. Tsolakes, *E synecheia tes Chronographias tou Ioannou Skylitze*, Tessalonike: 1968, f. 163.

⁴¹ Scylitzes-Kedrenos, *Synopsis ...*, f. 454; A. Ducellier, "L'Arbanon et les Albanais au XI^e siècle", në: *Travaux et Mémoires*, III, Paris: 1968, f. 359.

Uniteti gjeopolitik i viseve prej Durrësi në Arbër e në Maqedoninë Perëndimore shtrihej edhe në marrëdhëniet kishtare. Kryepeshkopët e Ohrit të kapërcimit të shek. XII-XIII, Teofilakti i Ohrit e Dhimitër Komatjanoi, e ushtronin autoritetin e tyre juridiko-fetar edhe në viset e Arbrit⁴². Akropoliti na rrëfen se Kryepeshkopi i Ohrit në 1246, Kostantin Kabasila, ashtu si dhe dy vëllezërit e tij, Joani e Teodori, i përkisnin një familjeje me origjinë nga Durrësi⁴³. Më herët, Kostantini kishte qenë pikërisht kryepeshkop i qytetit të tij të lindjes, Durrësit⁴⁴. Në murin verior të kishës së Shën Klementit (Shën Mëri Perivleptit) në Ohër, është pikturuar portreti i Shën Klementit së bashku me atë të Shën Kostantin Kabasilës. Konstantin Kabasila, Kryepeshkop i Ohrit aty nga mesi i shek. XIII, shfaqet i pikturuar edhe në kishën e Shën Joan Teologut e në kishën e vogël të Anargjirëve, po në Ohër⁴⁵. Shfaqja e kryepeshkopit Kabasila si shënjtör, shtron problemin e kanonizimit të tij, për të cilin nuk ka asnjë dëshmi të shkruar. Gjithashtu vlen të thuhet që, këto portrete të Kryepeshkopit Konstantin Kabasila si shënjtör lidhen me një periudhë të kufizuar, atë të sundimit të Perandorit Andronik II Paleolog (1282-1328), kohë kur edhe fisniku shqiptar, Progon Skurra, martuar me mbesën e Perandorit, Eudokinë, ndërtoi kishën e Shën Klementit, në fjalë. Dihet që periudha e sundimit të Perandorit Andronik II, ndërsa në planin kulturor ka përkuar me zhvillimin e një të ashtuquajturë “humanizëm” bizantin, në planin politik përkon me një periudhë decentralizimi e zhvillimi të autonomive lokale. Jo rastësisht, ashtu si në periudhën e vendosjes së regjimit të themave, në shek. IX-X, edhe tani, në kapërcim të shek. XIII-XIV, në strukturat drejtuese administrative e ushtarake provinciale, por edhe në ato qendrore bizantine, shfaqet me një prani të pazakontë elementi shqiptar⁴⁶. Në këtë kuadër, të karakterizuar nga ndikimi dhe

⁴² J. B. Pitra, *Analecta sacra et classica spicilegio Solesmensi parata*, vëll. VI, Romae, 1891, col. 1-48 dhe 423-437, 517-542.

⁴³ *Akropolites*, f. 166.

⁴⁴ D. M. Nicol, *The Despotate of Epiros*, Oxford, 1957, f. 166; A. Ducellier, *La façade...*, f. 70.

⁴⁵ R. Ljubinković-M. Čorović, “La peinture médiévale à Ohrid”, në: *Ohrid. Recueil de travaux du passé historique et culturel d’Ohrid*, Ohrid, 1961, f. 113-114.

⁴⁶ H. Hunger, “Zur Humanität Kaisers Andronikos II Palaeologos”, në: *Zbornik Radova Vizantologskij Institut*, flet. VIII, nr. 1: *Mélanges G. Ostrogorskij*, Beograd, 1963, f. 149-152; Pëllumb Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt. Berati e Vlora në shek. XII-XV*, Tiranë: 2008, f. 163-169.

promovimi i faktorëve politikë e kulturorë vendas, ndërsa në viset e Arbrit njohu një përhapje të madhe kulti i një shenjtori vendas, ai i Shën Gjjon Vladimirit⁴⁷, në trevat fqinje të Ohrit u përhap kulti i një tjetër shenjtori vendas, i kryepeshkopit Konstantin Kabasila. Nënvizojmë, që ky kult përkon me sundimin “liberal” të Andronikut II Paleolog dhe jo rastësisht, menjëherë pas tërheqjes së Bizantit nga kjo trevë, me ardhjen e pushtuesve të radhës, Nemanjiçëve serbë, kulti i Shën Konstantin Kabasilës u shua përfundimisht⁴⁸. Sa i përket origjinës dhe vendit historik të familjes Kabasila, një njoftim i vitit 1108, na flet për një Aleksandër Kabasila, i cili komandonte atë kohë trupat bizantine të dislokuara në kështjellën e Petrelës, në përpjekje për të ndalur marshimin drejt Ohrit të trupave normane të Boemundit, që tashmë kishin pushtuar Durrësin⁴⁹. Në fakt, janë disa dëshmi, që flasin për një origjinë durrsake të Kabasilave⁵⁰. Ne mund të shkojmë më tej e të themi se Kabasilat e Durrësit ishin me siguri shqiptarë. E jo thjesht sepse emri gjendet ende sot si emër familjeje e lokaliteti në mjaft krahina shqiptare. Fakti është që në vitin 1223, pikërisht në Durrës, përmendet një *Kabasila* dhe gruaja e tij *Kabasilina*, të cilët, siç thuhet, e kishin shtëpinë brenda kështjellës së Durrësit (ἐν τῷ τῷ κάστρου Δυρραχίου)⁵¹. Tani, ky Kabasila ishte bir i *Tanushit* (Τανούση) dhe nip i një personi me emrin *Gjon* (Γιόννης)⁵². Nuk ka dyshim, që këta emra tipikë shqiptarë thonë gjithçka mbi origjinën e tyre etnike, si dhe atë të djalit e të nipit të tyre, Kabasilës.

Nëse historia e trevës së Ohrit është e lidhur me emra familjesh të shquara shqiptare, siç ishin Skurrajt e Kabasilat e sipërpërmendur apo edhe vetë familja e Topiajve, “princër të Arbrit”⁵³, historia e një treve

⁴⁷ J. G. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena: 1854, f. 83-84; M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi ...*, f. 98-99.

⁴⁸ R. Ljubinković-M. Čorović, *La peinture médiévale à Ohrid*, f. 114.

⁴⁹ Anna Komnena, vëll. II, f. 190.

⁵⁰ Në vitin 1246, një farë Dhimitër Kabasila, *diakon* e *kastrensies* nënshkruante si dëshmitar në një akt noterial nga Durrësi, ku një ndër palët ishte Simon Vrana, edhe ky pinjoll i një familjeje të shquar durrsake (shih: *Acta Albaniae*), I, 181; A. Ducellier, *La façade...*, f. 199); J. B. Pitra, *Analecta sacra et classica spicilegio Solesmensi parata*, vëll. VII, f. 423 vj.

⁵¹ J. B. Pitra, *Analecta sacra et classica spicilegio Solesmensi parata*, vëll. VII, f. 423 vj.

⁵² *Po aty*, VII, 424; *Acta Albaniae*, I, 160.

⁵³ Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë: 1998, f. 50-51.

akoma më të gjerë të Maqedonisë Perëndimore, që veç Ohrit përfshinte edhe Dibrën e Pologun, është e lidhur për gati tre shekuj me familjen e bujarëve shqiptarë Gropa. Emri i tyre shfaqet më së pari në burimet historike në vitet '70 të shek. XIII. Atë kohë dëgjojmë të flitet për Pal Gropën, një personazh i shquar në radhët e fisnikërisë shqiptare të asaj kohe, që mbante titullin e lartë *sebast*⁵⁴. Këtë titull perandorët e Bizantit ua akordonin zakonisht krerëve të grupeve etnike të huaja⁵⁵. Nga një akt anzhuin i vitit 1273, rezulton se *sebasti* Pal Gropa zotëronte territore të gjera në viset e Dibrës. Akti në fjalë citon si prona të tij vendet e Radikës së Madhe e Radikës së Vogël, Kokobishtës, një vend tjetër të quajtur Zuadigorica, Sirklanin, Krajën e Zesicën⁵⁶. Vetëkuptohet që toponimet në fjalë janë deformuar nga shkruesi i huaj i aktit anzhuin. Megjithatë, ku më tepër e ku më pak, me siguri ata mund të identifikohen me emra vendesh që jetojnë ende në krahinën e Dibrës. Kështu, *Radika* ka mbetur sot si emër i një lumi që zbret nga krahu lindor i qytetit të Dibrës e vjen e bashkohet me Drinin e Zi, paksa në jug të tij. Me siguri në Mesjetë ekzistonte edhe një lokalitet me atë emër. Ne e dimë, në bazë edhe të shembujve të tjerë, që emrat e lumenjve shpesh herë e kishin origjinën tek emrat e vendbanimeve të njohura. Kështu, lumi Devoll u quajt me këtë emër nga qyteti i hershëm bizantin buzë tij, dhe po ashtu lumi Vrego u quajt me këtë emër falë qendrës tregtare që lindi në shek. XIII në derdhjen e tij⁵⁷. Vendin *Kobokishtë* të aktit të mësipërm anzhuin, studiuesi austriak Th. Ippen e identifikon me një farë *Kosoveci*.⁵⁸ Ne na duket më e mundshme ta çojmë Kokobishtën e Pal Gropës tek lokaliteti i sotëm me emrin *Kllloboçishtë*. Nga pikëpamja gjeografike, Kllloboçishta në fjalë ndodhet në afërsi të zotërimeve të tjera të identifikuara të Pal

⁵⁴ Dokumenti i plotë tek: J. Buchon, *Nouvelles recherches historiques sur la principauté française de Morée*, vëll. II, Paris: 1843, f. 303-304. Një regest të tij e kanë botuar: L. Thalloczy-C. Jireček-M. Šufflay, *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia (Acta Albaniae)*, vëll. I, Vjenë: 1913, nr. 300.

⁵⁵ H. Ahrweiler, *Sebaste-chef de groupes ethniques*, Polychronion, Heidelberg, 1966, f. 34-38.

⁵⁶ J. Buchon, *Nouvelles recherches historiques sur la principauté française de Morée*, vëll. II, Paris: 1843, f. 303-304; *Acta Albaniae*, I, 300.

⁵⁷ *Acta Albaniae*, I, 140, 649; *Acta Albaniae*, II, 6, 31, 89, 133, 319.

⁵⁸ Theodor Ippen, "Contribution à l'histoire de l'Albanie du XII au XV siècle", në: *Albania, Revue d'archéologie, d'histoire, d'art et des sciences appliqués*, a. 1932, f. 29.

Gropës dhe lidhet në mënyrë të natyrshme me to. *Zuadigorica* është me shumë gjasë *Gjorica* e sotme, që ndodhet paksa në Perëndim të Dibrës. *Sirkiani* i dokumentit tonë të vitit 1273 është me siguri *Zerqani*.⁵⁹ Gjithashtu *Kraja* është lehtësisht e identifikueshme me Krajën e sotme, kurse *Zessica*, që sipas dokumentit anzhuin ndodhej në luginën e një lumi me emrin e padeshifrueshëm *Ebu*, duhet të jetë *Zepishta* e sotme⁶⁰.

Sidoqoftë, duke patur parasysh shpërndarjen gjeografike dhe rëndësinë e lokaliteteve të sipërpërmendura, rezulton se sebasti Pal Gropa paska qenë një pronar mjaft i madh. Të tjerë zotërues tokash nga Dibra, që përmenden në dokumentacionin bizantin para tij, i përkasin me siguri një rangui më të ulët. Kështu, pronar i tillë ishte një farë Tanush Gjini, që përmendet aty nga viti 1230, por që i humbi tokat e tij, madje u shndërrua në një bujkrob (*paroikos*) të rëndomtë, ngaqë u përjashtua nga trashëgimia prej vëllezërve të tij⁶¹. Pronar më i rëndësishëm se Tanushi duhej të ishte një farë Gjergj Skorra, i cili përmendet në një letër të kryepeshkopit të Ohrit, Dhimitër Komajtani më 1224⁶². Ai mbiquhet aty si “*shumë i shquari zoti Gjergj Skorra*” (*megalepifanestatos*). Nëse do të pranohet që zotërimet e Skorrës shtriheshin rreth fshatit Konjarë, ku akoma ka një fis me emrin *Skorra*, mund të thonim se feudali Gjergj Skorra i vitit 1224 ishte një vasal i familjes Gropa. Në fakt, si pozicion gjeografik Konjara gjendet midis Dibrës, Kllloboçishtës e Gjoricës, pra përfshihej në zotërimet e Gropajve, në shtrirjen që ato na shfaqen në dokumentin anzhuin të vitit 1273.

Në kohën kur Gropajt shfaqen në dritën e historisë, treva e Dibrës ishte bërë objekt konflikti mes Perandorisë Bizantine dhe Mbretërisë serbe. Kjo, pasi në vitet e fundit të shek. XII kishte pushtuar qendrat kryesore të Kosovës e të Zetës (Mal i Zi), po vazhdonte të zgjerohej në drejtim të Jugut⁶³. Historiani bizantin Georgios Akropolites rrëfen se, aty nga vitet 1260, shqiptarët dibranë mundën të dëbojnë ushtritë bizantine

⁵⁹ *Po aty*, f. 29.

⁶⁰ Ippen e quan *Sebishta*, shih: Th. Ippen, *po aty*, f. 29.

⁶¹ J. B. Pitra, *Analecta sacra et classica Spicilegio Solesmensi parata*, vëll. VI, Paris: 1891, f. 425.

⁶² B. Ferjančić, “Pljemestvo u epirskoj državi prvje polovine XIII vjeka”, në: *Gllas*, nr. 343, kniga 5, Beograd: 1986, f. 151-153.

⁶³ S. Hafner, *Stefan Nemanja nach den Viten des Heiligen Sava und Stefans des Erstgekrönten*. Serbisches Mittelalter, Graz-Ëien-Köln, 1962, f. 82, 87; Constantin Jireček, *Geschichte der Serben*, I. Band, Gotha: 1911, f. 329.

dhe në të njëjtën kohë mbajtën larg nga viset e tyre inkursionet plaçkitëse të serbëve të Stefan Uroshit⁶⁴.

Megjithatë, në vitet e mëvonshme, gjendja ishte e ndërlikuar përderisa në vitin 1273 bujari Pal Gropa vendosi të verë zotërimet e tij nën sovranitetin e mbretit Karl I Anzhu i Napolit. Në atë kohë ky ishte bërë zot i brezit bregdetar midis Durrësit e Vlorës, duke përfshirë edhe Krujën, në sajë të marrëveshjes së arritur në fillim të vitit 1272 me bujarët shqiptarë nga dyert Skurra, Blinishti, Jonima, Arianiti, Vrana, Suma, Topia etj.⁶⁵ Emri i Gropajve mungon në këtë marrëveshje të parë me Anzhuinët. Pikat e marrëveshjes së vitit 1272 dihen dhe tashmë janë komentuar bollshëm. Bujarët shqiptarë njihnin Karlin I Anzhu si mbret të tyre, kurse ky i mernte nën mbrojtjen e tij sovranë bujarët në fjalë dhe zotërimet e tyre, si dhe garantonte njohjen e privilegjeve, akorduar atyre nga perandorët e vjetër të Bizantit, të titujve dhe të zakoneve të tyre të vjetra⁶⁶. Kemi të bëjmë, pra, me një kontratë tipike feudale midis kryezotit feudal dhe vasalëve të tij të rinj shqiptarë. Por, duhet thënë se, dinjitarët shqiptarë e bënë këtë hap vasalizimi ndaj mbretit anzhuin të Italisë së Jugut të shtyrë nga rrethanat e jashtëzakonshme që po kalonte vendi në atë kohë dhe e bënë atë jo pa hezitime, serioze. Në fakt, dihet që traktativat për të arritur në kompromisin e vitit 1272, zgjatën plot pesë vjet.

Gjithsesi, nuk kishte kaluar veç një vit pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, kur kreu i Dibrës, sebasti Pal Gropa vendosi t'i drejtohej edhe ai Karlit Anzhu, duke i propozuar këtij të fundit që zotërimet e tij të vihehin nën mbrojtjen anzhuine dhe ai vetë të njihte për kryezot sovran mbretin anzhuin. S'ka dyshim, që nëpërmjet një aleance me anzhuinët, Gropa kërkonte të siguronte një koperturë të jashtme kundër serbëve e bizantinëve, që kërcënonin zotërimet e tij. Në fakt, Anzhuinët ishin në marrëdhënie miqësore me Nemanjiçët serbë: madje mbreti Stefan Urosh I ishte martuar atë kohë me një princeshë anzhuine. Ndërkohë, marrëdhëniet me Perandorinë Bizantine ishin ato të një konflikti të hapur⁶⁷. Në rast se, mbreti Anzhu do të pranonte të vendoste lidhje

⁶⁴ Georgii Acropolitae, *Chronike syngraphe*, Lipsiae: 1903, f. 144-145.

⁶⁵ *Acta Albaniae*, I, 269, 333; P. Xhufi, "Shqiptarët përballë Anzhuinëve", në: *Studime Historike*, Tiranë, 1987, nr. 1, f. 210.

⁶⁶ "omnia privilegia eis concessa ab antiquis imperatoribus Romaniae et omnes bonos usus et consuetudines eorum", shih: *Acta Albaniae*, I, 269.

⁶⁷ G. Jireček, *Geschichte der Serben...*, f. 319-323.

vasaliteti me bujarin shqiptar, ai në bazë të së drejtës feudale obligohej automatikisht të merrte nën mbrojtje vasalin e tij të ri, Pal Gropën, e kështu të angazhohej në luftë me serbët për të ndalur zbritjen e mëtejshme të tyre drejt Dibrës. Do të detyrohej, gjithashtu, të angazhohej për të mbajtur larg nga ajo trevë kërcënimin tjetër, fuqinë bizantine. Pal Gropa, pra, i kishte bërë shumë mirë llogaritë e tij: lidhja e vasalitetit me Karlin I Anzhu i garantonte atij një mbrojtës autoritar, me aleanca të fuqishme në Evropë, që do të ishte në gjendje të mbante larg zotërimeve të Gropës si serbët, ashtu edhe bizantinët. Por mbreti anzhuin nuk ra në lojën e bujarit shqiptar. Në letrën e përgjigjes që i dërgonte Pal Gropës në maj të vitit 1273, Karli I Anzhu e njoftonte atë se, ishte gati të lidhej me fisnikun shqiptar dhe ta pranonte atë vasal të tij, por me kusht që zotërimi i tij të ishte i “lirë” dhe të mos bënte pjesë as në “Mbretërinë e Arbrit” (*Regnum Albaniae*) të shpallur nga anzhuinët, dhe as në mbretërinë e Serbisë. Pra, Pal Gropa mund t’i bashkohej anzhuinëve vetëm në rast se zotërimi i tij sillte një zgjerim të ri të sundimit anzhuin në Shqipëri dhe nuk bënte pjesë në territoret që tashmë e kishin njohur pushtetin e tyre, apo në territoret që i pretendonte Serbia, aleate e anzhuinëve⁶⁸.

Shkurt, në këtë rast mbreti anzhuin preferoi marrëdhëniet me serbët ndaj atyre me bujarin shqiptar Pal Gropa. Në fund të fundit, treva e Dibrës ishte jashtë interesave anzhuine, të cilat përqendroheshin në viset e Durrësit e të Vlorës dhe përgjatë itinerarit të rrugës Egnatia, në drejtimin Ohër-Selanik-Konstandinopojë, ku Karli I Anzhu ëndërronte të mbërrinte një ditë për t’u bërë zot i Bizantit⁶⁹.

Sidoqoftë, sebasti Pal Gropa bëri edhe një përpjekje të dytë për t’u marrë vesh me mbretin anzhuin. Në pranverë të vitit 1274 ai shkoi në Durrës për t’u takuar me mëkëmbësin e Karlit I Anzhu, kapitenin Nardo de Tusi⁷⁰. Interesante është se Pal Gropa paraqitet në këtë rast jo thjesht si përfaqësues i vetvetes, por i një grupi të tërë krerësh shqiptarë. Ne dimë, se përveç atyre krerëve që u lidhën me Karlin I Anzhu në vitin 1272, kishte edhe një grupim tjetër bujarësh shqiptarë që ende nuk i kishin përcaktuar marrëdhëniet e tyre me mbretin anzhuin. Bie në sy fakti, që në këtë mision përfaqësimi tek mëkëmbësi i mbretit Karl në

⁶⁸ “*dummodo non sint de pertinentiis regni nostri Albaniae, neque regni Servie*”, shih: *Acta Albaniae*, I, 300.

⁶⁹ A. Ducellier, *La façade maritime ...*, f. 230-232.

⁷⁰ *Acta Albaniae*, I, 318; K. Hopf, *Geschichte Griechenlands vom Beginn des Mittelalters bis auf zu unserer Zeit*, vëll. II, Leipzig: 1867, f. 300, shën. 74.

Durrës, Pal Gropa shoqërohej edhe nga një tjetër fisnik me emër, Gjin Muzaka, atë kohë zot i territoreve mes Beratit e Korçës⁷¹. Me sa duket, zë fill qysh nga ajo kohë miqësia dhe aleanca që këto dy familje feudale shqiptare do të ruajnë edhe në vitet e mëvonshme⁷².

Takimi i Durrësit, siç mund ta quajmë, nuk solli ndonjë gjë të re në marrëdhëniet e Pal Gropës, Gjin Muzakës e krerëve të tjerë shqiptarë që qëndronin pas tyre, me mbretin Karl I Anzhu. Është kuptimplotë fakti, që menjëherë pas këtij takimi, në dokumentet anzhuine mbi Shqipërinë fillon e flitet gjithnjë e më shumë për përleshje të armatosura mes atyre që cilësohen si “rebelë” shqiptarë dhe forcave anzhuine⁷³. Madje, në ndonjë rast, kryengritësit shqiptarë u ndjenë aq të fortë, sa të sulmonin edhe bastionet e sundimit anzhuin në Shqipëri, kështjellat e Durrësit e të Vlorës⁷⁴. Pikërisht në një nga betejat e shumta që u zhvilluan rreth mureve të Durrësit, Gjon Muzaka, shoqëruesi i Pal Gropës në bisedimet e Durrësit me mëkëmbësin anzhuin, u zu rob nga anzhuinët dhe u dërgua i lidhur me pranga në burgun e kështjellës së Brindizit në Itali⁷⁵. Bashkë me Muzakën, në të njëjtën kështjellë ishin burgosur edhe bujarë nga dyert Blinishti e Skurra, që i përkisnin grupimit të ashtuquajtur “filo-anzhuin”, që negociuan paqen me mbretin Karl, në vitin 1272⁷⁶. Një fakt i tillë tregon se rrethi armiqësor ndaj Karlit I Anzhu ishte zgjeruar, duke përfshirë edhe ish-vasalët e dikurshëm të tij.

Gjithsesi, marrëdhëniet e Gropajve me Anzhuinët mbetën edhe paskëta të ndera. Në vitin 1308, perandori titullar i Konstandinopojës, Karli Valua, kushëri e kryezot i princit anzhuin Filip i Tarentit, përmbylli me mbretin serb Stefan Urosh II një aleancë ushtarake kundër perandorit të Bizantit, Andronik II Paleolog. Kundrejt ndihmës që mbreti serb do t’i ofronte në përpykjen për ripushtimin e Konstandinopojës, pretendenti

⁷¹ K. Hopf, *Geschichte Griechenlands...*, II, f. 300, shën. 74; *Acta Albaniae*, I, 318; P. Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt...*, f. 280-282.

⁷² Midis Muzakajve dhe Gropajve ekzistonin edhe lidhje krushqie, shih: G. Musachi, *Genealogia*, në: Ch. Hopf, *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues*, Berlin: 1873, f. 281.

⁷³ A. Ducellier, *La façade maritime...*, f. 244; P. Xhufi, *Shqiptarët përballë Anzhuinëve...*, f. 213.

⁷⁴ *Acta Albaniae*, I, 323, 330.

⁷⁵ R. Minieri-Riccio, “Il regno di Carlo I d’Angiò”, në: *Archivio Storico Italiano*, 3 (1879), f. 163-164.

⁷⁶ *Acta Albaniae*, I, 396, 589.

francez pranonte t'i njihte Uroshit të drejtat e pronës mbi viset deri në rrjedhën e lumit Mat, duke përfshirë në Lindje edhe viset e Dibrës, së bashku me Përlepin, Kërçovën, Shtipin e viset e Ohrit⁷⁷. Të njëjtën gjë kishte bërë më 1299 perandori i Bizantit, Androniku II Paleolog, i cili në këtë mënyrë kishte dashur të fitonte miqësinë e mbretit serb⁷⁸. Fakti që një fisnik shqiptar, nga një tjetër derë e shquar, siç ishte ajo e Skurrajve, shfaqet në fund të shek. XIII si qeveritar bizantin i Ohrit, flet pikërisht për një dobësim të rolit të Gropajve në trevën Dibër-Ohër. Por ky dobësim ishte gjithsesi i përkohshëm, pasi në shek. XIV përmendet përsëri si zot i asaj treve Andrea Gropa, i cili në vitin 1389 mori pjesë bashkë me Teodor Muzakën, në betejën e Fushë-Kosovës⁷⁹. Në atë kohë, të dhënat historike, ndonëse të rralla, dëshmojnë një prani të qartë të elementit shqiptar jo vetëm në krahun e Dibrës e Tetovës, por edhe në atë të Shtipit e me siguri të Ohrit⁸⁰. Nga ana tjetër, vetë ekzistenca e bashkësive katolike edhe në Maqedoninë Perëndimore, njëlloj si në Kosovë, qysh në shek. XII, pra përpara pushtimit të tyre nga ana e shtetit serb të Nemanjiçëve, përbën një provë të qartë të ekzistencës së hershme të popullsisë shqiptare në këto anë⁸¹. Siç vërente Pjetër Bogdani, Arqipeshkv i Shkupit në 1685, në këto anë “Sllavët, për autonomasi, e quajnë fenë katolike si fe e shqiptarëve (*arbanaska vera*)”⁸². Kështu, në fund të shek. XIII, Ohri, që mbetej pika më veriore e zotërimeve bizantine, kishte akoma për kryezot një fisnik shqiptar, *heteriarkun e madh*, Progon Skurra. Ky, siç rezulton nga mbishkrimi i tij ktitorial në

⁷⁷ “*contrata a confinibus castris nomine Prilep usque ad confines castris nomine Priseq, et contrata Ouciepoullie usque ad confines castris nomine Stip, et contrata de Deber usque ad flumen nomine Mahat, et contrata Quiciaue usque ad confines Hoquerie*”, shih: *Acta Albaniae*, I, 589.

⁷⁸ G. Ostrogorsky, *Storia dell'Impero Bizantino*, Torino (Einaudi): 1968, f. 445.

⁷⁹ G. Musachi, *Genealogia*, f. 281-282; P. Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt...*, f. 271, 273.

⁸⁰ J. B. Pitra, *Analecta sacra et classica ...*, vëll. VI, col. 423-425, 517.

⁸¹ Kështu, në vitin 1204, flitet për një Arqipeshkv katolik të Shkupit, me emrin Marin, ndërkohë që Prizreni kishte po atë kohë si arqipeshkv katolik të quajturin Abraham. Shih: A. Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia*, tomus I (1198-1549), Roma: 1863, nr. 45, f. 29.

⁸² P. Bogdanus, *Cuneus Prophetarum*, pars prima, Patavii, 1685 (hyrje); P. Xhufi, “Albanian Heretics in the Serbian mediaeval Kingdom”, në: *The Truth on Kosova*. The Academy of Sciences of Republic of Albania, Tirana: 1993, f. 48-52.

kishën e Shën Klementit në kështjellën e Ohrit, ishte martuar me një mbesë të perandorit bizantin Andronik II, cilësohet aty si “dhëndërr” (*gambros*) i tij dhe për këtë arsye kishte fituar edhe titullin e lartë të *mezas heteriarkut*.⁸³ Progon Skurra dhe e shoqja e tij, Eudokia, i dhuruan kishës së themeluar prej tyre, një *podea* që paraqeste kryqëzimin e Krishtit⁸⁴.

Historia e Dibrës dhe e Gropajve dibranë në gjysmën e parë të shek. XIV, mbetet përgjithësisht e errët. Dimë megjithatë, se pas vdekjes së car Stefan Dushanit dhe shembjes së Perandorisë Serbe të ngritur prej tij, zot i trevës së Dibrës dhe asaj të Ohrit përmendet zhupani i madh, Andrea Gropa⁸⁵. Ky arriti edhe të presë monedhat e tij, gjë që tregon se kishte mundur të ngrejë një principatë mjaft të fuqishme⁸⁶. Andrea ishte dhëndër i bujarit tjetër të fuqishëm shqiptar, *despotit* Andrea Muzaka të Beratit⁸⁷. Në vitin 1271, Andrea shkoi në ndihmë të vjehrrit të tij në betejën për marrjen e Kosturit kundër princit serb Marko Krajleviç⁸⁸. Me thyerjen e këtij të fundit, jo vetëm Kosturi kaloi në duart e Muzakës, por edhe Ohri u mor prej Andrea Gropës. Ky fakt dëshmohet përveçse nga kronika e njohur e Gjon Muzakës, edhe nga një mbishkrim i kishës së përmendur të Shën Klementit i vitit 1378, ku Andrea Gropa cilësohet pikërisht zot i Ohrit⁸⁹. Pikërisht kësaj periudhe i referohet një mbishkrim historik mbi një kodik të Ohrit, i cili flet për lidhjet midis këtij qyteti dhe Karl Topisë, princit të Arbrit, pas vdekjes së Stefan Dushanit⁹⁰.

Në përfundim do të donim të shtronim edhe një konsideratë tonën lidhur me një pjesëmarrje të mundshme të Gropajve dhe të dibranëve në betejën e njohur të Fushë-Kosovës në 1389. Nga një njoftim i shkurtër i

⁸³ H. Gelzer, *Der Patriarchat von Achrída*, Leipzig: 1902, f. 13.

⁸⁴ A. Frolow, “La **podea**, un tissu décoratif de l’église byzantine”, në: *Byzantion*, XIII/2 (1938), f. 487; R. Ljubinković-M. Čorović, *La peinture médiévale à Ohrid*, f. 119.

⁸⁵ G. Musachi, *Genealogia...*, f. 281-282; P. Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt...*, f. 271, 273.

⁸⁶ C. Jireček, *Geschichte der Serben...*, f. 433; R. Mihajlčić, *Kraj srpskog carstva*, Beograd: 1975, f. 232.

⁸⁷ G. Musachi, *Genealogia...*, f. 282.

⁸⁸ *Po aty*.

⁸⁹ J. Ivanov, *Bllgarski starini iz Makedonije*, Sofija, 1970, f. 42.

⁹⁰ V. Mošin, “Les manuscrits du Musée National d’Ochrida”, në: *Ohrid. Recueil de travaux du passé historique et culturel d’Ohrid*, Ohrid: 1961, f. 174.

kronistit Gjon Muzaka, që shkruante në vitin 1510, ne dimë se vëllai i despotit Andrea Muzaka, Teodor Muzaka, mori pjesë bashkë me zotër të tjerë shqiptarë në betejën e Fushë-Kosovës, ku edhe humbi jetën⁹¹. Tani, nga rasti i përmendur i betejës së Kosturit më 1371, si dhe nga të tjera raste⁹², ne e dimë se sundimtarët e ndryshëm angazhoheshin me ushtri në territore larg zotërimeve të tyre, kur këtë ua impononte cilësia si vasal apo si farefis i feudalit të përfshirë drejtpërsëdrejti në konflikt. Duke e ditur se Muzakajt nuk kishin lidhje vasaliteti me asnjë nga zotërit e viseve të Kosovës e të Maqedonisë Perëndimore, duke ditur gjithashtu se lidhje të hershme e aktuale, përfshirë ato martesore, ata i lidhnin me Gropajt e Dibrës e të Ohrit, na duket më se e përligjur të supozojmë se Muzakajt shkuan në Betejën e Fushë-Kosovës të thirrur nga krushqit e miqtë e tyre të vjetër nga Dibra. Prania e Gropajve në Fushë-Kosovë duket, pra, të ketë qenë një fakt mjaft i sigurt.

S u m m a r y

THE IMPORTANCE OF WESTERN MACEDONIA IN THE HISTORY OF THE ALBANIANS FROM THE 7TH TO THE 15TH CENTURY

This study intends to throw light on the historic territory of this internal region, which is commonly called Western Macedonia. Until the beginning of Medieval, the ancient authors affirmed that the frontier between the Illyrian and the Greek world was somewhere in the north of Thessaloniki. Even during the medieval centuries the regions of Kostur, Ohrid, Skopje and Dibra are linked with the neighbor regions of Arbër, Devoll, Kolonja, being part of the same economic, administrative, military and church system. The data brought in this

⁹¹ “*Teodoro Mosachi secondo genito de nostra casa et altri signori d’Albania uniti insieme vennero alla bataglia, e fu rotti i Christiani, e ce morse il predicto Theodoro che portava seco grossa banda d’Albanesi*”, shih: G. Musachi, *Genealogia ...*, f. 273.

⁹² Nga *Kronika e Tokove* (fillimi shek. XV) mësojmë se në betejën e Kranesë kundër kontit Karl Toko (1412), sundimtarit shqiptar Gjin Zenebishi i erdhën në ndihmë krushqit e tij Shpata, Muzaka etj. Shih: G. Schirò, *Cronaca dei Tocco di Cefalonia*, Roma: 1975, f. 344.

case, show that even from an ethnic point of view, the territories of the western Macedonia were part of the Albanian cosmos. The Slavic invasion and settling during the sixth and seventh century touched the part of western Macedonia as well, even if the region was not on their principal trajectory. However, considering the great strategic role of these regions, where the principal arteries that linked Constantinople to Durrës and other ports passed, the Byzantine emperors from the eighth to the eleventh century applied a policy of displacement of the Slav settlers from these territories to the Asia Minor. As a result, the western Macedonian territories became a stronghold of security for the Byzantine Empire, during her confrontations with the Normans, the western crusades, the Anjouins and the Serbian royalty, on the eleventh and fourteenth century. The historic sources clearly emphasize the role of the descendants of the Arianits, Skurrajs, Gropajs, Muzakajs, Kabasilis on leading posts in the central and local byzantine administration or the structures of the churches in the regions mentioned. During the fourteenth and fifteenth century, the regions of Macedonia became part of the Albanian feudal owning. They became an arena of conflict with the successors of the Serbian Tsar Stefan Dushan and later with the new Ottoman invaders. The Ottoman danger directly touched the interests of the Albanian holders of those lands, and this was the reason why, being led by Teodor Muzaka, the holder of Berat and Kostur, they participated in the battle of Kosovo on 1389.